

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rrustemi: Kandidatura e Sejdiut ishte një mundësi e humbur, por zgjidhja për presidentin ende është e arritshme
ADRESA	https://albeu.com/kosove/rrustemi-kandidatura-e-sejdiut-ishte-nje-mundesi-e-humbur-por-zgjidhja-per-presidentin-ende-eshte-e-arritshme/1012841/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 14:40:33 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 14:37:12 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	19954fc3ddaa7f612f338edfda8e63961bdfcb188ce402c8fca1bb41631df5df
TEKSTI	8d7887f84bbfb9d1b08cc4758c1349058dcff3652122357375977160d2eeaaaf8
PAMJA	5efb96c098b98cccb1862d10d0b175f03f20398ade903f311186498652c5f096

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	30ea5f074f1ce77c9987c86465b4ab25b527167519ebfe5604ec501741faddb6
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	20a2ff67bec0970ebd6ac7b02e4b09aabe3ec6a4bb974bdfd1be2c012f68e490
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/30ea5f074f1ce77c9987c86465b4ab25b527167519ebfe5604ec501741faddb6>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Rrustemi: Kandidatura e Sejdiut ishte një mundësi e humbur, por zgjidhja për presidentin ende është e arritshme



Bekim Sejdiu, i konsideruar si një nga mundësitë e fundit për tejkalimin e ngërçit rreth zgjedhjes së presidentit, ka hequr dorë nga kandidatura. Ai bëri të ditur se vendimin e mori pasi nuk siguroi mbështetjen e nevojshme nga partitë politike, duke e bërë edhe më të vështirë procesin për zgjedhjen e kreut të shtetit.

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Adnan Rrustemi, deklaroi se partia e tij do të vijojë të kërkojë një kandidat të pranueshëm për të gjitha palët, me synimin që Kosova të mos shkojë në zgjedhje të reja.

Në një intervistë për Ekonomia Online, Rrustemi tha se vendimi i Sejdiut respektohet, por sipas tij, tërheqja e profesorës përbën një mundësi të humbur për vendin. Ai kujtoi se Sejdiu e kishte bërë publike arsyen e largimit dhe se kishte njoftuar për këtë kryeministrin Albin Kurti dhe kryetarin e LDK-së, Abdixhikun.

Rrustemi u shpreh se kandidatura e Sejdiut ishte propozuar si figurë konsensuale dhe jashtëpartiake pas marrëveshjes së arritur mes LVV-së dhe LDK-së, e cila ishte rezultat i negociatave të vështira. Sipas tij, vendimi lidhet edhe me refuzimin e 6 deputetëve të LDK-së për ta mbështetur apo zbatuar marrëveshjen. Ai shtoi se një president i tillë do t'i jepte fund krizës politike që lidhet me këtë çështje.

Deputeti i LVV-së e cilësoi tërheqjen e Sejdiut si një goditje për procesin, veçanërisht pas kundërshtimit që, sipas tij, 6 deputetë të LDK-së i kanë bërë marrëveshjes. Megjithatë, ai theksoi se kjo nuk do ta ndalë Vetëvendosjen të kërkojë një kandidat për president dhe të përpiqet të shmangë zgjedhjet e katërta radhazi, të cilat i konsideroi të panevojshme, të kushtueshme dhe të dëmshme.

Rrustemi tha se nuk ka informacion nëse do të organizohet një ftesë e re për partitë opozitare për të diskutuar rreth presidentit. Ai theksoi se LVV-ja i ka ftuar në vazhdimësi subjektet politike, ndërsa sipas tij, LDK-ja është

të fundit /



Rrustemi: Kandidatura e Sejdiut ishte një mundësi e humbur, p...



DHTIK dhe Komuna e Vitisë lidhin marrëveshje për...



Prokurorja Laura Pula përfundon karrierën dhe del në pension



Gruda: Shpresojmë që nesër katër ish-drejtuessit e UÇK-së t...



Investim në arsim i ABI Bank, gjithëpërfshirje dhe mundësi të...



Barcelona synon të transferojë te Manchester Unitedi...



Rodri rrefen cilin futbollist do të afronte te Barcelona



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

përgjigjur, kurse PDK-ja dhe koalicioni.

Ai nënvizoi se zgjedhja e presidentit kërkon konsensus dhe se asnjë subjekt nuk duhet ta përdorë këtë proces si arsye për të penguar funksionimin e institucioneve. Sipas Rustemit, për zgjedhjen e presidentit nevojitet mbështetja e 2/3 të deputetëve të Kuvendit të Kosovës, ndaj kjo nuk mund të arrihet nga një parti e vetme.

Rrustemi konfirmoi se kërkimi për një figurë konsensuale do të vazhdojë, por shtoi se procesi kërkon gatishmëri dhe vullnet politik edhe nga partitë e tjera opozitare. Ai u bëri thirrje partive dhe deputetëve që të marrin përgjegjësi politike e kushtetuese për ruajtjen e stabilitetit institucional dhe të mos e kthejnë zgjedhjen e presidentit në pjesë të përplasjes mes pozitës dhe opozitës.

Sipas tij, një kandidat mbipartiak dhe jashtëpartiak do të ishte zgjidhja më e përshtatshme për Kosovën dhe do të mundësonte tejkalimin e krizës aktuale politike.

Gjatë intervistës, Rustemi foli edhe për çështjen që Partia Demokratike e Kosovës ka dërguar në Gjykatën Kushtetuese lidhur me konstituimin e Kuvendit.

Ai tha se pret që Gjykata Kushtetuese të konfirmojë vazhdimin e funksionimit të institucioneve qendrore. Rustemi kujtoi se PDK-ja kishte kërkuar publikisht konstituimin e Kuvendit, por pasi ky proces u realizua, doli kundër tij dhe e dërgoi çështjen në Gjykatën Kushtetuese.

Deputeti i LVV-së deklaroi se pret që gjykata të vlerësojë se konstituimi i Kuvendit ishte i pashmangshëm pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve dhe se puna e institucioneve duhet të vazhdojë. Ai shtoi se nuk pret që çështja juridike të ndikojë në bisedimet e mundshme për zgjedhjen e presidentit, ndonëse tha se mbetet të shihet se si do të zhvillohet situata.

Rrustemi e përshkroi zgjedhjen e presidentit si një proces kryesisht politik, i cili varet nga vullneti i subjekteve parlamentare. Ai tha se, nëse partitë opozitare tregojnë vullnet për të gjetur një marrëveshje, është i bindur se zgjidhja do të arrihet.

Megjithatë, ai paralajmëroi se procesi do të vështirësohet nëse partitë e tjera e shohin çështjen e presidentit si mjet për ta penguar qeverisjen e Vetëvendosjes dhe për ta çuar vendin drejt zgjedhjeve, gjë që, sipas tij, duket se është synimi i tyre.

Shtuar më 15.09.2026 16:37

Tags: [Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje](#), [Sejdiu](#), [Tërheqja](#)



DHTIK dhe Komuna e Vitisë lidhin marrëveshje për përkrahjen e biznese...



Prokurorja Laura Pula përfundon karrierën dhe del në pension



Gruda: Shpresojmë që nesër katër ish-drejtnesit e UÇK-së të lirohen, të...



Dy muaj shtesë paraburgimi për Veselin dhe Krasniqin një ditë par...



Fetoshi: Vendimi i Hagës, një pikë ktheje historike për Kosovën



Thirrjet për dhunë para vendimit të Hagës – a rrezikojnë ato pozitën e t...



Ekspteri Shala: 16 shtatori kërkon vigjilencë, por nuk nënkupton...



Ndërpritën negociatat për presidentin mes LVV-së dhe LDK-së

